



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr 18 mot
dt 02.08.2024



VENDIM

Nr.12, datë 30.07.2024

PËR

**KORIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NË “VENDIMIN NR. 12, DATË
05.09.2012 PËR MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË
REZERVËS UJORE PËR PRODHIM HIDROENERGJIE” DHE
KORIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NË “LEJEN PËR PËRDORIM
REZERVE UJORE PËR PRODHIM ENERGJIE NR. 12, DATË
05.09.2012,” SHOQËRISË TUCEP SH.P.K”**

Bazuar në pikën 2, neni 50, të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, si dhe në pikën 1 e 2, nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative: "Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ, me kërkesë të Subjektit dhe me aprovim të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore pasi konstatoi se kërkesa e subjektit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Drin Bunë,

V E N D O S I:

1. Korigjimin e gabimit material në Vendimin Nr 12, datë 05.09.2012 “Për miratimin e lejes për përdorim të rezervës ujore për prodhim hidroenergjie” të Këshillit të Basenit Ujor Drin-Bunë, shoqërisë “TUCEP shpk”:
Pas fjalës VENDOSI:, paragrafi i parë, kuota e veprës së marrjes në përroin e Tucepit +936m, është bërë gabimi material në vlerën +936m ndërkohë që duhet të jetë kuota e veprës së marrjes në përroin e Tucepit +735.7 m.
2. Korigjimin e gabimit material në Vendimin Nr 12, datë 05.09.2012 “Për miratimin e lejes për përdorim të rezervës ujore për prodhim hidroenergjie” të Këshillit të Basenit Ujor Drin-Bunë, shoqërisë “TUCEP shpk”:

Pas fjalës VENDOSI:, paragrafi i parë; deri në godinën e centralit në kuotën +850m, është bërë gabimi material në vlerën +850m ndërkohë që duhet të jetë deri në godinën e centralit në kuotën +666.4m.

3. Korigjimin e gabimit material në “Lejen për përdorim rezerve ujore për prodhim energjie nr.12, datë 05.09.2012”, të Këshillit të Basenit Ujor Drin Bunë, shoqërisë “TUCEP shpk”:

Në pikën B-Objekti i lejes dhe specifikimet e tij: vepra e marrrjes do të ndërtohet në kuotën Z +936m në Përroin e Tuceptit, është bërë gabimi material në vlerën +936m ndërkohë që duhet të jetë vepra e marrrjes do të ndërtohet në kuotën Z +735.7m në Përroin e Tuceptit.

4. Korigjimin e gabimit material në “Lejen për përdorim rezerve ujore për prodhim energjie nr.12, datë 05.09.2012”, të Këshillit të Basenit Ujor Drin Bunë, shoqërisë “TUCEP shpk”:

Në pikën B-Objekti i lejes dhe specifikimet e tij:

Ndërtesa e centralit do të ndërtohet në kuotën Z +850m, është bërë gabimi material në vlerën +850m ndërkohë që duhet të jetë ndërtesa e centralit do të ndërtohet në kuotën Z +666.4m.

5. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

